



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5593 Prot.

Lezhë, më 31 . 03 . 2021

VENDIM

Nr. 53 Datë 30 . 03 . 2021

Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.110, datë 24.02.2021, VKM nr. 149, datë 10.03.2021; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3572/2, datë 08.03.2021 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.110, datë 24.02.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtesë në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 478,059,460 lekë.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Planifikimi Urban Vendor” në shumën 478,059,460 lekë. Veprimet të kryhen si më poshtë :

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 në shumën 478,059,460 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.606 në shumën 478,059,460 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

